



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 22 (827877)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 7 qershor 2024



Shqipëria mirëpret Konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit (BCHOD's)





Shqipëria mirëpret Konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit (BCHOD's)

Nga data 5 deri më 7 qershor 2024, u zhvillua në vendin tonë konferenca e 17-të e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit (BCHOD's). Konferenca u organizua nga vendi pritës Shqipëria.

Në konferencë morën pjesë vendet anëtare të iniciativës rajonale të Shefave të Shtabit të Përgjithshëm: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Rumania, Bullgaria, Turqia, Greqia, Bosnjë - Hercegovina dhe Serbia, si dhe 2 vende vëzhguese Sllovenia dhe Kroacia. Sllovenia u përfaqësua nga SHSHP, gjenerallejtënant Robert Glavas, ndërsa Kroacia nga drejtori i Drejtorisë së Operacioneve, gjeneralmajor Denis Tretinjak.

Në këtë aktivitet të rëndësishëm të drejtuesve më të lartë ushtarakë të vendeve të Ballkanit morën pjesë edhe përfaqësues nga Komiteti Ushtarak i BE-së, drejtori i Kabinetit të Kryetarit të Komitetit Ushtarak të BE-së, gjeneralmajor Johann Frank dhe nga Komanda e Forcës së Bashkuar e NATO-s (JFC) Napoli, Itali, zëvendëskomandanti i JFC Napoli, gjenerallejtënant Stephen Kelsey (CAN Army).

Konferencën e nderuan me pjesëmarrjen e tyre të ftuar VIP, Presidenti i Republikës së Shqipërisë SH. T. z. Bajram Begaj dhe ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi.

Qëllimi i iniciativës së Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit është promovimi dhe forcimi i paqes dhe sigurisë rajonale nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak të vendeve anëtare.

Fjalën përshëndetëse të hapjes së konferencës e mbajti shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji.

Konferencën e përshëndetën Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH. T. z. Bajram Begaj, si dhe Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, z. Niko Peleshi.

Më tej konferenca vijoi punimet me Raportin vjetor të Grupit Koordinues, Nëngrupi Punues për Kërcënimet Asimetrike dhe Nëngrupi Punues për Trajnime dhe Ushtrime Arsimore. Vlerësimi nga CHOD mbi aktivitetet e GK dhe SWG.

Në konferencë pati diskutime nga CHOD-të mbi temën e konferencës që ishte "Angazhimi i të rinjve në mbrojtje dhe siguri: Promovimi i përfshirjes së të rinjve në çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë, nxitja e inovacionit dhe adresimi i sfidave të rekrutimit dhe mbajtjes në ushtri". Por gjithashtu u mbajtën prezantime kombëtare (Athinë, Ankara dhe Tiranë).

Fjala përmbyllëse e konferencës u mbajt nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, CHOD gjeneralmajor Arben Kingji.

Në fund u nënshkrua Deklarata e Përbashkët e Konferencës së 17-të BCHOD.

Teksa u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve, ministri Peleshi u shpreh se ky vit e gjen Shqipërinë në ballë të një morie angazhimesh rajonale.

"Roli i Shqipërisë në zhvillimin e bashkëpunimit rajonal, si dhe kontributi ynë i vazhdueshëm në garantimin dhe ruajtjen e sigurisë, stabilitetit dhe prosperitetit në rajon, qëndrojnë të palëkundura. Ne jemi paqedashës dhe të qartë në orientimin tonë drejt familjes perëndimore, ashtu siç jemi forcë shumëfishuese për vlerat dhe dinjitetin njerëzor, në një botë të udhëhequr nga rregullat", - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Sipas tij, "Ministria e Mbrojtjes, në koherencë të plotë me politikën e jashtme të qeverisë shqiptare, vijon të ketë në fokusin e saj promovimin e fqinjësisë së mirë, pranimit të njëri - tjetrit, integrimin e plotë Euro-Atlantik dhe forcimin e bashkëpunimit dhe



zhvillimit rajonal, pasi së bashku mund të bëjmë më mirë dhe më shumë për vendet tona dhe rajonin".

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi tha se Ballkani i ka përjetuar të gjitha proceset, procese që kanë ndryshuar rrjedhën e historisë, dhe problematikat e të cilave ndihen qartësisht dhe sot. "Historia pa dyshim nuk ka qenë shumë e dashur me ne, por ndërkohë që e

kujtojmë atë (pasi ajo nuk mund të harrohet dhe është pjesë e identitetit kombëtar), nuk duhet të mbetemi peng i së shkuarës. Është thelbësore të tejkalohen problemet etnike, kulturore dhe politike që kanë qenë vetëm burim konfliktesh. Unë mbetem shpresëplotë që mësimet i kemi nxjerrë, edhe pse periodikisht, fatkeqësisht, jemi dëshmitarë të akteve terroriste dhe kriminale përqark rajonit tonë dhe shpeshherë dëgjojmë zëra përçarës e zjarr-nxitës.

Prandaj duhet vazhduar me reforma gjithëpërfshirëse që shumë prej vendeve tona kanë përfunduar, ku në qendër janë politika më të sigurt dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e ndërlidhës mes nesh", - theksoi ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi.

Duke e cilësuar këtë dekadë si 10-vjeçarin e paparashikueshëm, Ministri i Mbrojtjes vuri në dukje kontributin që Shqipëria dhe Forcat e Armatosura veçanërisht japin përmes misioneve në Kosovë, Bosnje, Letoni, Bullgari, Irak, Detin Mesdhe dhe Egje, Sudanin e Jugut dhe Sinai. Nisur nga tema e kësaj konference "Angazhimi i të rinjve në mbrojtje dhe siguri: Promovimi dhe

përfshirja e të rinjve në çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes, përf forcimin e inovacionit dhe sfidat e rekrutimit në ushtri", ministri i Mbrojtjes z. Peleshi tha se afrimi i sa më shumë të rinjve në Forcat e Armatosura është prioritet i Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë.

Në fjalën e tij përshëndetëse presidenti i Republikës, SH. T. z. Bajram Begaj e cilësoi këtë konferencë si një instrument mjaft



të rëndësishëm për bashkëpunimin mes vendeve dhe stabilitetin në rajon. Kreu i Shtetit tha se sfidat e sigurisë janë në rritje çdo ditë, ndaj kjo situatë kërkon Forca të Armatosura të përgatitura.

“Rinia është garancia e së ardhmes. Edukimi i tyre me kulturën e dialogut, respektit reciprok, të pranimit të diversitetit dhe të fqinjësisë së mirë krijon kushtet për një të ardhme më të mirë dhe më të sigurt. Rinia është e ardhmja e Forcave tona të Armatosura dhe burimi i inovacionit që mund të ndryshojë mënyrën se si ne mendojmë dhe veprojmë në fushën e mbrojtjes, përfshirja e saj aktive në siguri dhe mbrojtje është e rëndësishme për të nxitur një ndryshim pozitiv dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e strategjive afatgjata”, - u shpreh presidenti Bajram Begaj.

Më tej presidenti Bajram Begaj theksoi se: “Ju si Shefa të Shtabeve të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të vendeve të Ballkanit, jeni kolonat mbi të cilat mbështetet paqja dhe siguria e këtij rajoni. Ne jemi dëshmitarë të një bote që ndryshon me shpejtësi, ku sfidat e sigurisë janë në rritje dhe ndryshojnë çdo ditë.

Nga kërcënimet kibernetike, klimatike deri te krizat humanitare dhe konfliktet rajonale, sot është e rëndësishme që të kemi Forca të Armatosura, të cilat të jenë të përgatitura, fleksibël dhe proaktive. Në veçanti, agresioni i padrejtë rus kundër Ukrainës ka treguar jo vetëm brishtësinë e arkitekturës së sigurisë botërore, por edhe se si po ndryshon vetë arti i luftës. Lufta moderne tashmë nuk është një luftë konvencionale, por ka natyrë hibride dhe asimetrike.

Kemi detyrën dhe misionin historik që Ballkani të shndërrohet në një rajon të integruar, ku të mbizotërojë mirëkuptimi, bashkëpunimi i gjithanshëm, paqja dhe orientimi i palëkundur Euroatlantik. Shqiptarët kanë qenë dhe do të jenë gjithmonë faktor paqeje,

stabiliteti dhe bashkëpunimi.

Si anëtare e NATO-s dhe kandidate tashmë me përvojë të gjatë në procesin e anëtarësimit, pavarësisht se ngelemi shumë shpesh në klasë, Shqipëria mbështet çdo iniciativë dhe nismë që krijon kushtet për bashkëpunim, bazuar te fqinjësia e mirë dhe respekti reciprok.

Jemi të vetëdijshëm që kemi ende sfida përpara. Këto sfida tejkalohen duke përmirësuar marrëdhëniet ndërshtetërore, duke zgjidhur mosmarrëveshjet e vjetra përmes diplomacisë aktive, si dhe duke bashkëpunuar më ngushtë në mbrojtjen e përbashkët për të krijuar një rrjet të sigurisë rajonale.

Kam bindjen se Konferenca e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të vendeve të Ballkanit, konferenca juaj, do të vijojë të jetë pararojë në promovimin e bashkëpunimit në funksion të paqes dhe sigurisë. Ju më shumë se kushdo tjetër e njihni vlerën që ka paqja në parandalimin e tmerreve të luftës.

E përshëndes pjesëmarrjen e Kroacisë dhe Sllovenisë si vëzhguese në këtë konferencë, por ky forum, më lejoni të them, do të ishte akoma më i plotë me pjesëmarrjen e Republikës së Kosovës. Gjej rastin të përshëndes vendimin e Asamblesë së NATO-s për avancimin e statusit të Kosovës si anëtare të asociuar, si një hap drejt një rajoni më të sigurt dhe më evropian.

E kam theksuar dhe do të vijoj ta theksoj se anëtarësimi i Kosovës në iniciativa dhe organizata ndërkombëtare politike dhe të sigurisë në rajon, por edhe globale, si Karta e Adriatikut A5, do të jetë vlerë e shtuar dhe kontribut i jashtëzakonshëm për paqen dhe sigurinë.

Le të punojmë së bashku, si një rajon i bashkuar, për të përballuar sfidat dhe për të shfrytëzuar mundësitë që na ofron kjo epokë e re, të cilën po e jetojmë”, - përfundoi fjalën e tij presidenti Bajram Begaj.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben



Kingji, duke iu drejtuar homologëve të tij tha: “Të gjitha këto sfida ndaj sigurisë nuk mund të menaxhohen pa një qasje të përbashkët rajonale. Në këtë kuadër forumi ynë qëndron si një mjet i rëndësishëm dhe i përshtatshëm për të përparuar në ndërtimin e respektit dhe besimit reciprok si dhe arritjen e një kuptimi të përbashkët mes nesh”.

Në këtë nismë rajonale vendet pjesëmarrëse ishin: Shqipëria, si vend pritës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Rumania, Bullgaria, Turqia, Greqia, Bosnjë - Hercegovina dhe Serbia. Kroacia dhe Sllovenia morën pjesë në cilësinë e vendit vëzhgues të iniciativës.

Qëllimi i iniciativës së Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit është promovimi dhe forcimi i paqes dhe sigurisë rajonale nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak të vendeve anëtare.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet të rëndësishëm të drejtuesve më të lartë ushtarakë të vendeve të Ballkanit ishin edhe përfaqësues nga Komiteti Ushtarak i BE-së dhe Komanda e Forcës së Bashkuar e NATO-s (JFC) Napoli, Itali.

Si lindi Iniciativa e BCHODs

Më datë 18 prill 2007, Shefat e Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Ballkanit (Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia, Rumania, Serbia, Shqipëria dhe Turqia) firmosën Termat e Referencës të forumit të BCHODs për bashkëpunimin ushtarak.

Me këtë akt, të gjithë pjesëmarrësit u angazhuan për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, duke zhvilluar bashkëpunimin ushtarak më qëllim rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në Ballkan, për t’i paraprirë sfidave të mundshme të përbashkëta në rajon. Rritja e bashkëpunimit ushtarak edhe në fushën e edukimit trajnimit dhe stërvitjeve është një ndër temat kryesore të kësaj iniciative.

Konferenca vjetore e BCHODs vlerësohet si një instrument i rëndësishëm për promovimin e sigurisë dhe stabilitetit rajonal nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak. Forumi mund të pranojë anëtarë të rinj vetëm mbi bazën e konsensusit. Si traditë e këtij forumi, Shefat e Shtabeve të Përgjithshëm të Kroacisë dhe Sllovenisë janë ftuar çdo vit që prej nismës së saj.

Në konferencën vjetore të BCHODs tradicionalisht janë ftuar edhe Kryetari i Komitetit Ushtarak i BE-së, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Komandanti i Komandës Amerikane në Evropë dhe Komandanti i Komandës së Bashkuar të NATO-s në Napoli.

Radha e zhvillimit të konferencave bëhet sipas rendit alfabetik të kryeqyteteve. Gjithashtu, bazuar në rotacionin e organizimit të konferencës pasardhëse, vendi organizator merr Sekretariatën e konferencës dhe përgjigjet për menaxhimin e informacionit, organizimin e takimeve të Grupeve të Punës si dhe përgatitjen dhe organizimin e konferencës së BCHODs.



Hackathoni i Kriptografisë, një rrugëtim i ri për studentët e AFA-së



Hackathoni i Kriptografisë, nis rrugëtimin drejt krijimit të një algoritmi dhe çelësve Kombëtarë të Kriptimit! Nën mentorimin e Qendrës së Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, studentët e Masterit Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” të AFA-së, nisën një përvojë të jashtëzakonshme për të shfaqur aftësitë e tyre në krijimin e një algoritmi të rëndësishëm kombëtar!



SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji priti gjeneralallejtënant Alexander Sollfrank

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji priti në komandantin e Komandës së Bashkuar të Mbështetjes dhe Mundësimit të NATO-s, gjeneralallejtënant Alexander Sollfrank. Në takim ata diskutuan mbi rëndësinë e kësaj komande për mbështetjen e operacioneve të NATO-s dhe ambicien e Shqipërisë për një rol aktiv në këtë drejtim. Gjithashtu në takim u diskutua dhe mbi mundësitë që ofron pozicioni strategjik i vendit tonë, si një portë e rëndësishme rrugëkalimi nga perëndimi në lindje, në sajë të zhvillimit të projektit të Porto Romano-s, infrastrukturës së Korridorit 8-të dhe projekteve të tjera.



Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia priti atasheun ushtarak të SHBA-ve dhe këshilltarin pranë Ministrit Mbrojtjes

Në ambientet e komandës së Forcës Tokësore, komandanti i FT-së, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, priti në një takim kortezie Atasheun e Mbrojtjes të SHBA-ve, kapiten i rangut II Eric Cote si dhe z. Hinton, Këshilltarin amerikan pranë Ministrit të Mbrojtjes.

Komandanti i FT-së, gjeneralmajor Xhebexhia, pas urimit të mirëseardhjes, i njohu më hollësisht miqtë amerikanë për planin e zhvillimit të FT-së si dhe me projektet kryesore të modernizimit dhe infrastrukturës të FT-së. Pala amerikane nga ana e saj shprehu falënderime për bashkëpunimin e shkëlqyer midis ushtrive të dy vendeve tona, duke u zotuar që do të jetë përherë e gatshme për të mbështetur Forcën Tokësore në rrugën e saj të modernizimit.



Forca Detare/Roja Bregdetare vazhdon misionin e saj fisnik në shpëtimin e jetëve njerëzore, në kuadër të Aleancës

Anija “Lissus”, e cila ndodhet në mision në detin Egje, gjatë patrullimit finalizoi me sukses operacionin e kërkim-shpëtimit. Operacioni i erdhi në ndihmë emigrantëve të paligjshëm, të cilët lundronin në kushte të vështira lundimore dhe rrezikonin të mbyteshin. Pas koordinimit të anijes “Lissus” me Rojën Bregdetare turke u bë i mundur shpëtimi i 23 emigrantëve me kombësi nga Palestina, Somalia dhe Jemeni. Emigrantët, 21 meshkuj dhe 2 femra ndodhen në gjendje të mirë shëndetësore dhe u morën nga Roja Bregdetare turke për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.



Kontingjenti XV EOD i bashkohet grup-batalionit kanadez, në kuadër të misionit të e-FP në Riga, Letoni

Në ambientet e Batalionit të Xhenios u zhvillua ceremonia për nisjen e kontingjentit XV EOD, i cili do t'i atashohet grup-batalionit kanadez për t'u radhitur përkrah vendeve të tjera aleate të NATO-s, për kryerjen e misionit të radhës në Riga, Letoni.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj, drejtori i Operacioneve në Shtabin e Përgjithshëm, kolonel Elton Bregu, drejtori i BCU-së, kolonel Arjan Osmani, efektivë të Batalionit të Xhenios, familjarë të kontingjentit EOD dhe të ftuar të tjerë.

Komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj, në fjalën e hapjes shprehu mirënjohje dhe falënderim për Shtabin e Përgjithshëm dhe Komandën Mbështetëse, për mbështetjen e treguar për kontingjentet EOD, ku në mënyrë të veçantë falënderoi efektivët e kontingjentit XV për përkushtimin, sakrificën dhe për detyrën fisnike që ata kanë marrë përsipër për të realizuar në këtë mision sa të vështirë, por aq dhe domethënëse. Ndër të tjera ai u shpreh me bindje se kontingjenti XV do të jetë vazhdues i denjë i rrugës së nisur nga kontingjentet e mëparshme.

Kolonel Elton Bregu, në emër të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, përcolli urimet më të mira për kontingjentin.

Komandanti i kontingjentit XV, major Klodian Nuredini, u shpreh në emër të kontingjentit se me disiplinën, profesionalizmin, dashurinë dhe krenarinë për atdheun, do të rrisin vlerat e Forcave të Armatosura, me përfaqësimin e tyre në këtë mision.

Në përfundim të ceremonisë zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, i dorëzoi kontingjentit XV flamurin kombëtar dhe më pas u realizua një foto e përbashkët.



Një tjetër operacion në ndihmë të komunitetit i përfunduar me sukses

Në fshatin Biter, njësi administrative Koms, bashkia Mat, efektivët e kompanisë së punimeve xheniere të Batalionit të Xhenios, kanë punuar në mënyrë sistematike dhe kanë përfunduar me sukses detyrën për shembjen e kontrolluar të masivit shkëmbor.

Për më shumë se dy javë, duke përdorur pajisje, teknika, njohuritë e duhura e mbi të gjitha falë eksperiencës së krijuar ndër vite nga specialistët xhenierë, u realizua shkatërrimi i masivit shkëmbor, nëpërmjet shpërthimit të kontrolluar dhe në mënyrë mekanike, duke i dhënë mundësinë banorëve të fshatit Batër e Madhe të lëvizin lirshëm e të sigurt në drejtim të fshatit Batër e Vogël dhe qytetit të Burrelit.

Për inspektimin e punimeve, ka qenë i pranishëm zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, i cili falënderoi ekipin xhenier për përkushtimin dhe njëkohësisht realizoi takim me përfaqësuesit e pushtetit lokal, të cilët shprehën mirënjohje për shërbimin e paçmuar që i bëhet kësaj zone.

Efektivët e kompanisë së punimeve xheniere do të jenë gjithmonë të gatshëm për t'iu përgjigjur në çdo kohë kërkesave për ndihmë të komunitetit, në të gjithë territorin e vendit tonë.



KOLONEL ARBEN DHULI

Blockchain është një teknologji, e cila mundëson një shpërndarje më të shpejtë dhe me kosto më efikase të produkteve, si dhe ndikon të rrisë gjurmueshmërinë e produkteve, përmirëson koordinimin ndërmjet partnerëve dhe ndihmon në aksesin e financimit. Blockchain gjithashtu mund të përpilojë të dhëna për lëvizjet e kontejnerëve të transportit (kryesisht detar), duke përcaktuar rrugë më të shpejta të zinxhirit të furnizimit për udhëtimet e ardhshme si dhe krijon mundësinë për ndërmjetësit dhe hapat e tjerë të panevojshëm.

Ky koncept është aq i gjerë sa nuk mund të përshkruhet me pak fjalë. Ai është një sekuencë e tërë ngjarjesh, një proces i lëvizjes së mallrave. Është një rrjet organizatash të përfshira në proces dhe karakterizohet nga lidhje të gjera me furnitorët dhe marrësit. Është e sigurt që ky proces përbëhet nga një rrjet i impianteve, ndërmarrjeve dhe prodhuesve, si dhe kontraktorëve, të cilët, së pari, furnizojnë lëndët e para dhe komponentët përbërës, dhe së dyti, i përpunojnë ato në përbërës dhe produkte gjysmë të gatshme dhe më pas, këto produkte gjysmë të gatshme dhe përbërës përdoren për të prodhuar një produkt përfundimtar që arrin te konsumatori.

Qëllimi themelor i menaxhimit të zinxhirit të furnizimit, ku logjistika është pjesë, është rritja e përfitimit financiar. Kjo për shkak se është e mundur të zvogëlohet kostoja e mallrave të shitura. Përfshirë logjistikën, prodhimin, marrjen dhe transformimin e lëndëve të para, magazinimi i mallrave ose transporti, si dhe të gjitha llojet e tarifave dhe kostot e punës arrijnë deri në 80% të kostove të shitjes.

Gjithashtu një nga qëllimet kryesore të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit është zvogëlimi i kostove të kompanisë dhe rritja e efikasitetit. Ashtu si bota e sotme, po ashtu zinxhirët e furnizimit tani janë shumë kompleksë dhe ende në zhvillim. Efikasiteti i zinxhirëve të furnizimit varet nga fleksibiliteti. Kjo për shkak se klientët kanë një gamë të gjerë zgjedhjesh dhe opsione të ndryshme blerjeje. Ata mund të blejnë lirisht produkte në dyqan të palëvizshme dhe në internet. Klientët tani janë të fokusuar në personalizimin dhe vetëm bashkëkohor dhe një zinxhir furnizimi fleksibël mund t'ua sigurojë këtë. Ndërsa bota ecën përpara, burimi vazhdon të evoluojë dhe tani është jashtëzakonisht i rrjedhshëm. Aftësia për të rikonfiguruar në mënyrë fleksibël, të shpejtë dhe pa probleme zinxhirët e furnizimit është shumë e rëndësishme.

Krijimi i një bashkëpunimi efektiv që do të mundësojë koordinimin automatik të logjistikës nga ana e furnitorëve dhe blerësve, ofrimi i klientëve të fundit me produkte të vlefshme dhe me cilësi të lartë, vëmendje për stabilizimin afatgjatë dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Në këtë proces, një rol të rëndësishëm luan planifikimi dhe zbatimi i çdo aktiviteti në mënyrë optimale, pra duke filluar nga cikli i blerjes së materialit deri te cikli i porosisë. Këto aktivitete kryhen për të plotësuar nevojat e konsumatorëve, duke parashikuar dhe pastaj duke shfrytëzuar mundësitë dhe arritur:

- Blockchain ofron një regjistër të decentralizuar, i cili është rezistent nga manipulimet e ndryshme, ku transaksionet regjistrohen në blloqe. Çdo bllok është i lidhur me atë të mëparshmin, duke krijuar një zinxhir informacioni transparent dhe të pandryshueshëm.

Në zinxhirët e furnizimit, kjo transparencë mund të ndihmojë në gjurmimin e lëvizjes së mallrave, verifikimin e origjinës së tyre dhe sigurimin e pajtueshmërisë me rregulloret. Për shembull, mund të përdoret për të gjurmuar udhëtimin e një produkti nga lëndët e para te konsumatori përfundimtar. Kontratat inteligjente janë marrëveshje vetë-ekzekutuese me rregulla të paracaktuara. Kur plotësohen disa kushte, ato aktivizojnë veprime automatikisht.

- Në logjistikë, kontratat inteligjente mund të automatizojnë procese të tilla si shlyerjet e pagesave, konfirmimet e dorëzimit dhe menaxhimin e inventarit. Për shembull, kur një dërgesë arrin destinacionin e saj, kontrata e zgjuar mund të lirojë pagesën për transportuesin.

- Transparenca ndihmon në parandalimin e mashtrimit dhe falsifikimit. Duke regjistruar çdo hap të rrugëtimit të një produkti, bëhet e vështirë futja e mallrave të rreme në zinxhirin e furnizimit.

Kompanitë mund të përdorin Blockchain për të verifikuar vërtetësinë e artikujve me vlerë të lartë (p.sh. mallra luksoze, farmaceutike) dhe për të parandaluar ndryshimet e paautorizuara.

- Futja e furnizuesit është shpesh një proces që kërkon kohë, por Blockchain mund ta thjeshtojë këtë, duke përshpejtuar procesin e hyrjes.


Ngjarjet e papritura (fatkeqësitë natyrore, çështjet gjeopolitike, etj.) mund të prishin zinxhirët e furnizimit. Zgjidhjet e bazuara në Blockchain lejojnë shikueshmëri në kohë reale në operacione.

Kur plotësohen kushtet e paracaktuara të biznesit (p.sh. vonesat, problemet e cilësisë), kontratat inteligjente nxisin veprime, duke mundësuar përgjigje më të shpejta dhe minimizuar ndërprerjet.

Në përmbledhje, Blockchain mund të revolucionarizojë logjistikën dhe menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, duke rritur transparencën, automatizimin e proceseve dhe duke përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm. Miratimi i tij po rritet vazhdimisht pasi kompanitë njohin përfitimet e tij të mundshme. Kërkimi i Blockchain në logjistikë dhe SCM synon të përdorë natyrën e decentralizuar dhe të sigurt të teknologjisë për të rritur transparencën, gjurmueshmërinë dhe efikasitetin në të gjithë zinxhirët e furnizimit. Studiuesit vazhdojnë të eksplorojnë potencialin e tij dhe të adresojnë sfidat praktike në zbatimin e zgjidhjeve të Blockchain për skenarët e logjistikës në botën reale.

Kompanitë moderne bëjnë gjithçka për të qenë në gjendje të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, sepse vetëm një bashkëpunim i tillë rrit efikasitetin dhe lejon uljen e kostove që lidhen me drejtimin e një

"Blockchain" në logjistikë dhe përdorimi i tij në zinxhirin e furnizimit



kompanie. Kjo qasje ndaj biznesit na lejon gjithashtu të përshtatemi me nevojat e klientëve. Menaxhimi në çdo kohë i zinxhirit të furnizimit është përshtatur për ndërmarrjen. Në ditët e sotme, është e pamundur të imagjinohet funksionimi i një kompanie pa një zinxhir efektiv furnizimi. Është thelbi i logjistikës së çdo sipërmarrjeje, pavarësisht nga profili i kompanisë dhe pavarësisht nga profili i klientëve të saj. Ato lejojnë krijimin e vlerës për të gjitha palët në kontratë dhe sigurojnë sukses tregtar. Kjo, nga ana tjetër, ndikon në mirëqenien sociale dhe gjendjen e mjedisit natyror. Një lloj tjetër zinxhiri i furnizimit është zinxhiri i furnizimit të gjelbër (zinxhiri i përgjegjshëm i furnizimit). Karakteristike të zinxhirit i furnizimit të qëndrueshëm është se procesi i tij përfshin të ashtuquajturat ide të operacioneve të gjelbra dhe dizajnit të gjelbër, si dhe prodhimin të gjelbër. Ky model përmban gjithashtu logjistikë të kundërt dhe menaxhim të mbetjeve.

Sistemet konvencionale kundrejt Blockchain, librat financiarë dhe sistemet e planifikimit të burimeve të ndërmarrjes të përdorura tani nuk lejojnë në mënyrë të besueshme tre palët e përfshira në një transaksion të thjeshtë të zinxhirit të furnizimit të shohin të gjitha flukset përkatëse të informacionit, inventarit dhe parave. Një sistem Blockchain eliminon pikat e verbra. Gabimet e ekzekutimit - të tilla si gabimet në të dhënat e inventarit, dërgesat që mungojnë dhe pagesat e dyfishta - shpesh janë të pamundura të zbulohen në kohë reale. Edhe kur një problem zbulohet pas faktit, është e vështirë dhe e kushtueshme për të identifikuar burimin e tij ose për ta rregulluar atë duke gjurmuar sekuencën e aktiviteteve të regjistruara në regjistrimet dhe dokumentet e disponueshme të librit. Megjithatë sistemet ERP kapin të gjitha llojet e flukseve, mund të jetë e vështirë të vlerësohet se cilat shënime në ditar (llogaritë e arkëtueshme, pagesat, kreditë për kthime, etj.) korrespondojnë me cilin transaksion të inventarit. Kjo është veçanërisht e vërtetë për kompanitë e përfshira në mijëra transaksione çdo ditë përmes një rrjeti të madh partnerësh dhe produktesh të zinxhirit të furnizimit.

Për shembull, porositë, dërgesat dhe pagesat mund të mos sinkronizohen mirë, sepse një porosi mund të ndahet në disa dërgesa dhe fatura përkatëse, ose porosi të shumta mund të kombinohen në një dërgesë të vetme. Një qasje e zakonshme për përmirësimin e ekzekutimit të zinxhirit të furnizimit është verifikimi i transaksioneve përmes auditimeve. Auditimi është i nevojshëm për të siguruar pajtueshmërinë me kontratat, por është një ndihmë e kufizuar në përmirësimin e vendimmarrjes për të adresuar mangësitë operacionale. Merrni parasysh problemin me të cilin përballet një kompani ushqimore kur produktet e saj arrijnë fundin e afatit të tyre (skadencës) në një dyqan me pakicë. Nga një studim me një prodhues të madh të ushqimeve të paketuara, u zbulua se një auditim ose një inspektim i inventarit në një dyqan mund të zbulojë numrin e artikujve të skaduar, por nuk do të shpjegojë shkaqet.



Kontratat inteligjente mund të programohen për të vlerësuar statusin e një transaksioni dhe për të ndërmarrë automatikisht veprime të tilla si lëshimi i një pagese, regjistrimet në libër dhe shënimi i përjashtimeve që kanë nevojë për ndërhyrje manuale.

Është e rëndësishme të theksohet se një Blockchain nuk do të zëvendësojë gamën e gjerë të funksioneve të përpunimit të transaksioneve, kontabilitetit dhe menaxhimit të kryera nga sistemet ERP, të tilla si faturimi, pagesa dhe raportimi. Në të vërtetë,

lista e lidhur e koduar ose struktura e të dhënave në formë zinxhiri të një Blockchain nuk është e përshtatshme për ruajtje dhe rikuperim të shpejtë apo edhe ruajtje efikase. Në vend të kësaj, Blockchain do të ndërli dhe me sistemet e trashëgimisë nëpër firmat pjesëmarrëse. Çdo firmë do të gjeneronte blloqe transaksionesh nga sistemi i saj i brendshëm ERP dhe do t'i shtonte ato në Blockchain. Zinxhiri i furnizimit është në thelb, gjaku që lejon bizneset të funksionojnë, të rriten dhe të inovojnë. Sipas fjalëve të industrialistit të famshëm Henry Ford, "Të bëhesh bashkë është një fillim, të qëndrosh së bashku është përparim dhe të punosh së bashku është sukses".

Gjithashtu historitë e suksesit të kompanive si "Amazon", "Apple", "Unilever" dhe "Tesla", ndër të tjera, shfaqin një potencial të jashtëzakonshëm. Këta liderë të industrisë kanë shfrytëzuar zinxhirët e tyre të furnizimit për të krijuar avantazhe konkurruese, për të

kapur tregje të reja dhe për të ripërcaktuar standardet e industrisë. Qoftë nëpërmjet burimeve etike, inovacionit teknologjik ose strategjive efektive të globalizimit, ato demonstrojnë rolin kritik që luan në përcaktimin e suksesit të një kompanie. Këto histori suksesi ofrojnë një pamje gjithëpërfshirëse se si kompanitë kryesore përdorin zinxhirët e tyre të furnizimit si asete strategjike. Ato ofrojnë frymëzim, njohuri dhe mësim praktikë për bizneset që kërkojnë përparësi konkurruese. Çështja kryesore është: një zinxhir furnizimi i mirë-projektuar dhe i menaxhuar me ekspertizë nuk është vetëm një funksion mbështetës; është një shtytës kyç i suksesit të biznesit dhe një katalizator për udhëheqjen e industrisë. Nëse një produkt është i prishshëm (siç janë produktet e freskëta dhe disa ilaçe), Blockchain lejon kompanitë pjesëmarrëse të monitorojnë cilësinë automatikisht: Një enë frigoriferike e pajisur me një pajisje interneti të gjërave (IoT) për të monitoruar temperaturën mund të regjistrojë çdo luhajtje të pasigurt në Blockchain. Dhe nëse ka shqetësime në lidhje me origjinalitetin e një produkti që një shitës me pakicë e kthen, Blockchain mund t'i lehtësojë ato, sepse mallrave të falsifikuara do t'u mungonte një histori verifikimi në Blockchain. Prandaj kompanitë në të gjithë industrinë po eksplorojnë këtë aplikim të Blockchain-it, të motivuar ose nga rregulloret që u kërkojnë atyre të demonstrojnë origjinën e produktet e tyre ose nga klientët e rrjedhës së poshtme që kërkojnë aftësinë për të gjurmuar inventarin e komponentëve. Bota e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit është vazhdimisht në lëvizje, e nxitur nga teknologjia, globalizimi dhe kërkesat e konsumatorëve.

Inteligjenca artificiale po revolucionarizon parashikimet, automatizimin dhe vendimmarrjen, duke e transformuar zinxhirin e furnizimit në një sistem më të zgjuar dhe më të përgjegjshëm.

Transparenca dhe gjurmueshmëria janë thelbësore në zinxhirin e furnizimit të sotëm dhe Blockchain po e bën atë të ndodhë. Ky libër dixhital i decentralizuar ofron gjurmim të sigurt dhe transparent, duke nxitur besimin dhe efikasitetin. Shpërthimi i blerjeve në internet, veçanërisht pas pandemisë, po riformulon mënyrën se si produktet ruhen, paktohen dhe shpërndahen. Është një trend që ka ardhur për të qëndruar dhe zinxhiri i furnizimit po zhvillohet për të përmbyshur këtë kërkesë të re. Me një rrjet ligjesh dhe rregulloresh gjithnjë në rritje, qëndrimi në përputhje është një sfidë komplekse dhe vazhdimisht në ndryshim. Ajo kërkon vigjilencë, fleksibilitet dhe një kuptim të thellë të peizazheve ligjore lokale dhe globale. Ndërsa zinxhiri i furnizimit bëhet dixhital, kërcënimet e sulmeve kibernetike duket i madh. Mbrojtja e informacionit dhe sistemeve të ndjeshme nga shkeljet është një përparësi kryesore, që kërkon masa të forta sigurie.

Megjithatë, bota e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit nuk është pa sfidat e saj. Gjetja e profesionistëve të aftë që mund të lundrojnë në botën që ndryshon me shpejtësi të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit po bëhet më e vështirë. Trajnimi dhe mbajtja e talentit është një sfidë kritike që kërkon vëmendje. Nuk ka të bëjë vetëm me lëvizjen e mallrave nga një vend në tjetrin; ka të bëjë me krijimin e vlerës, nxitjen e qëndrueshmërisë, përgjigjen ndaj kërkesave të tregut dhe kryerjen e të gjithave me integritet etik. Tendencat në zhvillim, përparimet teknologjike dhe ndërprerjet globale riformësojnë vazhdimisht peizazhin, duke kërkuar vigjilencë të vazhdueshme, inovacion dhe përshtatshmëri. Qëndrueshmëria dhe etika janë shfaqur gjithashtu si konsiderata kritike, duke reflektuar një kërkesë në rritje të shoqërisë për praktika të përgjegjshme biznesi. Suksesi në këtë fushë kërkon të menduarit strategjik, një gatishmëri për të përqafuar ndryshimin dhe një përkushtim ndaj vlerave që rezonojnë me konsumatorët dhe shoqërinë në përgjithësi.

Në mbyllje, trajtimi me qasje të shumanshme të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit, përshkruan një pamje të gjallë të një fushe që është njëkohësisht sfiduese dhe emocionuese. Jetojmë në një botë botë, ku inovacioni takohet me praktikitetin, ku etika ndërthuret me ekonominë dhe ku udhëheqja vizionare mund të transformojë të zakonshmen në të jashtëzakonshme. Peizazhi gjithnjë në zhvillim i menaxhimit të zinxhirit të furnizimit është një dëshmi e zgjuarsisë njerëzore dhe ndjekjes së pamëshirshme të përsosmërisë. Është një histori përparimi dhe potenciali, një histori që na fton të gjithëve të angazhohemi, eksplorojmë dhe kontribuojmë në një të ardhme ku bizneset jo vetëm që kanë sukses, por lulëzojnë në harmoni me botën përreth tyre.

KIJTIM BORIÇI



“Ditari i gazetarit...”, libri i 34-t i publicistit dhe shkrimtarit ushtarak Kujtim Boriçi

NAIM DËRAJ
STUDIUES


Indodhur në atmosferën emocionuese që të jep biblioteka, me të fshehtat, intrigat, dashuritë, luftërat për jetën dhe frontet, shkak-pasojat etj... titujt e shumëllojshëm të botimeve të autorëve të plejadave të ndryshme, më të afirmuarit e deri te më të rinjtë, ishte e pamundur të mos rrëmbeshe nga ndjesia se ishe brenda një “perandorie hijerëndë”, e cila të rrëmbente paqesisht brenda saj. Duke ecur me vështirimin mbërthyer në titujt e librave, sytë më mbetën në kopertinën ku një portret gravurë me ballin e lartë mbi të cilin flokët e trazuar e të shpupuritur të krijonin përfytyrimin se personi sapo kishte ardhur aty pas një udhëtimi të gjatë e të vështirë nëpër vërshëllimat karakteristike të erërave të maleve tona. Ishte libri i ri i Kujtim Boriçi: “Nga blloku i shënimeve të Gazetarit...”.

Autori është shumë i njohur në media, me shkrimet e shumëllojshme në gazeta të ndryshme, por Ai ka bërë vend edhe me botimin e shumë librave me poezi, poema, legjenda e rrëfime, monografi, tregime e novela dhe publicistikë. Shumë nga shkrimet e botuara prej tij në shtypin periodik i kam ndjekur me vëmendje dhe më kanë bërë për vete me mënyrën e thjeshtë, por edhe për argumentet në përmbajtjen dhe analizën e problemeve që trajtojnë. Disa prej librave me këtë autor i kam lexuar me kërshtëri dhe më kanë krijuar mendimin se secili prej tyre përbën një pjesë interesante në tablonë e larmishme të jetës së njerëzve dhe trevave të ndryshme të vendit tonë.

E mora në dorë librin e ri dhe meqë ishte voluminoz, mendova ta lexoja gradualisht pa u sforcur, por më ndodhi e kundërta. Që në parathënien e librit gazetarja e mirënjohur Anila Basha shprehet: “...Pena e Kujtim Boriçi ka skicuar në “ditar” copëzat e jetës së gazetarit, që nuk jeton dot vetëm jetën e tij, por edhe të personazheve

realë të shoqërisë...”. Rresht pas rreshti që në shkrimet e para pashë se e kisha të pamundur të shkëputesha. Që në shkrimin e parë më del para syve figura e një mësuesi, pamja e të cilit e rrënuar ekonomikisht dhe fizikisht, duke e parë që rrëmonte në pargjet e mbeturinave, bëri të më mblidhet një lëmsh në grykë. Kjo situatë përjetohet, jo pse rrëmonte në mbeturina, sepse çdo punë e ndershme meriton të respektohet, por për faktin se figura e mësuesit meriton të vlerësohet denjësisht edhe financiarisht, në mënyrë që Ai për t’i dhënë shoqërisë më shumë duhet të ketë mundësi ta përdorë kohën duke kërkuar e promovuar vlerat nëpër libra. Pasi përfundova së lexuari shkrimin e parë dhe kalova tek i dyti, një tjetër befasi njerëzore bëhet e pranishme, duke më përfshirë dhe duke përjetuar fuqishëm ndjesitë e asaj situatë.

Duke u njohur me një episod që tregon nga jeta feminare e autorit njeriu përjeton dhimbje; kjo për arsye se një i ashtuquajtur mësues (që nuk u bë dot kurrë mësues), brutalisht dhe pa shkak e



godet me pëllëmbë në mes të nxënësve të tjerë. Bashkë me dhimbjen fizike veprimi negativ shkaktoi te fëmija, të cilin babai e kishte lënë jetim që në moshën 5 vjeçare, dhimbje shpirtërore. Me këtë ndjesi në shpirtin e lënduar Ai shkon e i tregon nënës, e cila kur pa tronditjen e të birit, e mbajti brenda vetes dhimbjen dhe i drejtohet: “Biri im! Mos u mërzit që të goditi. Të goditi se je jetim dhe je pa mbrojtje, por mëso bir se do bëhesh zot i vetes!”.

Bekimi i Nënës

Kujtimi nuk bën deklarata të bujshme, por kuptohet natyrshëm se ato fjalë të dala nga goja dhe zemra e nënës që rriti fëmijët e vet jetimë (kur babai i tyre u nda nga jeta në moshë të re, dy vëllezërit e tjerë të Kujtimit ishin më të vegjël nga Ai), i kanë dhënë Atij shtysë të fuqishme për të ecur në jetë. Ato fjalë zemre kanë qenë tharmi që kanë mbrujtur shpirtin sfidant që në hapat e hershme të fëmijërisë dhe adoleshencës. Ato nuk përmbanin vetëm dëshirën për të birin që të ecte, por ishin bekimi për të përballuar sfidat e jetës. Ato fjalë-bekim i janë bërë balsam në dhimbje dhe forcë në përballje të vështira. Shoqëruar nga ato fjalë Kujtimi adoleshent, tanimë skënderbegas, hodhi në letër rreshtat që u bënë teksti i këngës: “Urimi i Nënës”, e cila kompozuar nga Spartak Tili dhe interpretuar me ngrohtësi nga Luan Zegu, u bë kënga fituese e anketës muzikore të muajit korrik, të vitit 1974. Për të kuptuar se ç’ ishte kjo arritje, mjafton të dimë se për një njeri në atë moshë, ishte ëndërr e madhe të botonte disa rreshta në mediat e asaj kohe.

Në atë këngë, ku janë të shkruara në një: teksti, muzika dhe interpretimi i ngrohtë, ndihet fuqishëm krenaria e të qenit ushtar i atdheut dhe porosia e nënës: “Ruaje, ruaje këtë tokë që të rriti!” Ishte porosia e njeriut më të shtrenjtë të jetës, që ishte bërë nënë dhe babë për të rritur tre fëmijët jetimë. Kështu që në fillim të adoleshencës fëmija i burrëruar dhe pjekur para kohe zë vend denjësisht në radhën e emrave të njohur të vendit në fushën e krijimtarisë letrare, duke ngjitur një shkallë të dukshme në rrugën e gjatë dhe të vështirë të krijimtarisë. Në këtë rrugë të suksesshme, në vitin 1977 libri i Kujtimit: “Këngët tona” zgjidhet ndër tre librat më të mirë të poetëve të rinj. Me atë rast, në sallën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë u organizua diskutimi i librave të Kujtimit dhe kolegëve: Ilirjana Sulkuqi dhe Xhevdet Shehut. Në podium, në krah të Ismail Kadaresë dhe Fatos Arapit, ishte edhe Kujtimi me dy kolegët e tjerë fitues. Ishte 22 vjeç dhe më i riu ndër tre kolegët fitues. Tanimë në mendjen e tij ishte krijuar bindja se idealet e dobëta thahen nga rrebeshet, kurse idealet e fuqishme, rriten e bëhen më të forta. Rrugëtimi në jetë i Kujtimit, që nga ajo kohë e në çdo hap është dinjitoz. Këtë fakt e konstatojnë njerëzit e afërt, shokët e miqtë e shumtë, por edhe ata që nuk e njohin nga afër, por janë miqësuar me të nëpërmjet shkrimeve e librave që ka botuar. Nuk dihet nëse është ndikimi i të atit apo geni trashëgues, që për rrjedhojë edhe fëmijët janë bërë profesionistë në gazetari, por kjo mund të kuptohet disi duke u njohur me shkrimin për vajzën e tij gazetare, që përgatiste një emision në ditët e dimrit të acartë. Është kuptimplotë fakti që në kohën kur njeriu arrin në një fazë të tillë të begatë të jetës, bashkë me bekimin e marrë që në vegjëli dëgjon këto fjalë nga nëna e tij, kur Ajo ishte i afruar të 90-tave: “Nuk ka rëndësi

bir se çfarë pune bëni ju e fëmijët, rëndësi ka që të jeni njerëz të dobishëm. Jam shumë e kënaqur me ju e kështu qofshi, gjithnjë në krah të së mirës...!”. Nëna e dhimbсур tanimë e shihte të realizuar bekimin e saj dhe shihte e bindur se ish fëmija i burrëruar e i pjekur nga jeta kishte bërë vend denjësisht në radhët e njerëzve të mirë, të aftë dhe pararojë të shoqërisë.

Në llogoren për beteja në të mirë të shoqërisë

Në fillim, kur kisha shfletuar vetëm disa dhjetra faqe të librit, e kuptova se “i kisha hyrë detit në këmbë” dhe që andej nuk mund të dilej lehtë. Më tej, për disa orë çdo ditë me radhë i kalova duke ecur rresht pas rreshti e faqe pas faqeje derisa brenda 8-9 ditësh arrita të përfundoja së lexuari gjithë librin. Tanimë në mendje më rrinin personazhe të shumtë, të cilët ndërthurur me mendimet e qëndrimet e shprehura më dukej se isha bërë bashkëbisedues me shumë prej tyre. Ndër këta personazhe gjenden që nga fëmijët deri te të moshuarit vërsnik me shekullin, kurse bazuar në emrat dhe arritjet e tyre në jetë janë të pranishëm që nga njeriu më i thjeshtë deri te personalitetet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat përkatëse të zhvillimit shoqëror. Shprehur me terminologjinë e biologut: në atë panoramë të paanë janë në harmoni dhe origjinalitet llojet e panumërta natyrore që nga fija e barit e deri te lisat madhështorë. Autori merr pjesë dhe përjeton bashkë me personazhet e shkrimeve të tij situata nga më të larmishmet; duke filluar nga ato më të lumturat e deri te më të dhimbshmet e dramatiket.

Në situatat e lumtura Kujtimi shkrihet e bëhet një me pjesëmarrësit. Kjo ndodh në rastet kur është i pranishëm në vizita e takime me miq e shokë ose dhe organizator në veprimtari artistike e kulturore. Në këto raste Ai shkëputet përkohësisht nga preokupimet maksimale që imponojnë diskutime për probleme të mprehta e të vështira, por pa harruar se është gazetar. Janë domethënëse çastet e lumtura që përjeton autori në takim me ish-ushtarakët e lartë, të cilët me gjithë debatet e ashpra ndërmjet tyre për mendimet e kundërta politike, arrin t’i ulë në kafe gjeneralët hijerëndë. Ajo kafe besoj se ka qenë mjalt e shkuar mjaltit për ish-skënderbegasin e vogël, tanimë bashkëbisedues i denjë e i besuar. Mjedise mbushur me atmosferë shumë të ngrohtë na përshkruhen në shkrimet për teqenë bektashiane me emrin “Durballi-Sulltan” në territorin e sotëm të Greqisë, për miqësinë e studentëve shqiptarë me aktorin e famshëm Raxh Kapuri, takimi në Turqi me tregtarin me origjinë shqiptare në Stamboll dhe rikujtimi i vjershës “poçari” të Dritëroit të paharruar. Me ngjyra të theksuara përjetohet e pasqyrohet veprimtaria e majit të vitit 2016, ku mes personaliteteve të njohura nga shumë vende të botës është i pranishëm Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve; Shkëlqesia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Në disa shkrime të librit janë hedhur pjesë të humorit original nga takime e biseda ku autori ka qenë i pranishëm. Kujtimi i ka përjetuar me dhimbje të thellë ndarjen nga jeta të kolegëve të tij. Në çaste të tilla dhimbja dhe nderimi për kolegun e ndarë nga kjo botë është njerëzore dhe tregues i karakterit fisnik.

Në kërkim të lajmeve të vërteta, përgjegjësia e të qenit gazetar nuk e shmang dot edhe nga ato raste të dhimbshme kur bëhet fjalë për ngjarje të rënda tragjike, të cilat i përcjell me vërtetësi, por edhe me shumë dhimbje. Këtë ndjesi gazetari profesionist e

përcjell edhe në raste kur personazhet pothuajse ishin mbuluar nga koha e gjatë dhe mungesa e njohjeve. I tillë është shkrimi për oficerin gjerman, nënkolonel Wolfgang Kleiss, i cili nga rob lufte, u bashkua me forcat partizane dhe dha jetën duke çminuar disa mina luftarake në Sarandë.

Në këtë libër peshë të rëndë kanë episodet, ngjarjet dhe analizat që trajtojnë probleme të ndjeshme dhe të rëndësishme të shoqërisë dhe atdheut tonë. Në këto raste autori, jo vetëm gjen dhe u shkon të vërtetave të lajmit deri në rrënjë, por njëherazi përballlet me vendosmëri e profesionalizëm, duke mos bërë pazare e duke mos u trembur nga presionet që vijnë nga persona që përfaqësojnë qarqet e larta kriminale apo shtetërore. Idealet atdhetare mëkuar që me qumështin e nënës dhe reflekset e ushtarakut me vullnet të fortë e përballin denjësisht me personazhe negativë dhe fenomenet e dëmshme për shoqërinë ku jeton. Të tilla janë shkrimet ku denoncohen rastet e trafikut të fëmijëve jetimë nga rrjetet kriminale, vrasjet e bëra në kufi nga ushtarët maqedonas, apo denoncimi i marrëveshjes detare me Greqinë. Duke u njohur me shkrimet në këtë libër, natyrshëm dallon se brenda tyre së bashku me personazhet, është edhe autori, i cili me reflekset e ushtarakut dhe gazetarit profesionist e atdhetar është i pozicionuar fuqishëm në llogore për beteja në mbrojtje të vlerave tona shoqërore e atdhetare.

Botime të autorit Kujtim Boriçi

Kujtim Boriçi u lind në vitin 1955. Është autor i disa librave me poezi, prozë dhe publicistikë. Si gazetar profesionist ka punuar për dekada në shtypin ushtarak, në gazetatat “Shekulli”, “Gazeta Shqiptare”, “Dita” dhe së fundi në gazetën “Telegraf” si kryeredaktor i saj. Është autor i mijëra shkrimeve në median e shkruar. Librin e parë poetik e ka botuar në vitin 1977.

Ndër librat e tij përmendim: “Këngët Tona”, vëllim me poezi; “Ata erdhën nga Stebleva...”, publicistikë; “Dashuria është kudo”, poezi; “Tragjedia e Gjeneralëve”, monografi historike; “Misteret e trafikut të armëve në Shqipëri”, (me bashkautor); “Jeta në burgjet shqiptare”, publicistikë; “Gjeneral Llakaj, shefi i shtatmadhorisë shqiptare mes dy puçeve ushtarake”, monografi historike; “Dasmë e ndërprerë në mes”, novelë; “Fqinjësi e përgjakur”, publicistikë; “Dy martiret e Steblevës”, monografi; “Duan të na e vjedhin Qemal Stafën”, tregime; “Ali Kopaçi, personalitet dhe njeri”, monografi, “Ushtarakët e Gollobordës, Vol, I”, (me bashkautor); “Gjyqi i Kadri Hazbiut”, arkiva-histori (në botim); “Skënderbegasit ndër vite”, pjesa e parë, (me bashkautor); “Një jetë në qiell”, monografi; “Histori e shkruar me gjak atdhedashurie”, monografi (me bashkautor); “Baba Shefqet Gillava, martir i demokracisë”, monografi (me bashkautor); “Skënderbegasit ndër vite”, pjesa e dytë, (me bashkautor); “Skënderbegasit ndër vite”, pjesa e tretë, (me bashkautor); “Skënderbegasit ndër vite”, pjesa e katërt, (me bashkautor); “Bedinajt e Kaninës, gjurmë në histori”, monografi; “Oficeret shqiptare në rrjedhën e historisë”, pjesa e parë, (me bashkautor); “Oficeret shqiptare në rrjedhën e historisë”, pjesa e dytë, (me bashkautor); “100 personalitete të Librazhdit”; “Dede Edmond Brahimaj, 10 vjet Kryegjysh Botëror i Bektashizmit”, (me bashkautor); “Naim Frashëri, apostull dhe bilbil i bektashizmit”, me bashkautor; “Tahir Hoxha i Çermenikës”, monografi; “Legjenda të Gollobordës”, legjenda dhe rrëfime; “Gollobordës”, poemë; “Ditari i gazetarit”, pjesa e dytë.

Redaksia e shtypit ushtarak, i uron suksese të mtejshme, mikut dhe bashkëpunëtorit të gazetës “Ushtria” dhe revistës “Mbrojtja”, z. Kujtim Boriçi.

Lexuesi shqiptar ka nevojë për publicistikë dhe krijimtari autentike dhe të vlerë si këto që sjellin kjo plejadë shkrimtarësh.

LIRIKA DASHURIE

Në 40-vjetorin e martesës

*Para pasqyrës u gjendëm një çast, si dikur,
E njëri-tjetrin vështruam sy ndër sy,
Po ajo dhomë, si 40 vjet më parë,
Protagonistë si atëherë, po ne të dy.*

*Por unë një det me thinja në flokë kam,
Ty ca thinja të holla ta kanë qëndisur ballin,
...Një fllad i ëmbël hap dritaren e vjen,
Dy bulëza lotësh, një puthje, ç’na e shtojnë mallin...*

*Të përqaftuar u rrëzuam mbi shtratin e bardhë,
Ashtu si natën e parë të martesës,
Një zë i ëmbël na preu mallin e viteve,
Ishte në derë, trokitja e mbesës...*

Përjetë mirënjohës veprës tuaj sublime

Raqi Qirinxhi

Raqi Qirinxhi ishte me shtat mesatar, jo fort i gjatë, i bëshëm, por “dru thane”, siç thotë populli. Cilësitë e larta morale e shpirtërore, Raqi i kaliti dhe më tepër kur mori pjesë në LANÇ, si anëtar i orëve të para të PKS-së. Raqi ishte dhe mësues i Liceut të Korçës dhe partizan. Nxënësve u mësonte shkencat në shkollë, ndërsa aktivistët i njëjti me parimet dhe nevojën e luftës revolucionare për çlirimin e Atdheut. I ashpër dhe i drejtë ishte ai në mësimin e matematikës dhe të shkencave të natyrës, por më shumë akoma në mësimin e shkencës së revolucionit. Në mbrëmje u kërkonte llogari “nxënësve” të vet për punën revolucionare që kishte zhvilluar me masat, të nesërmen ai i kërkonte llogari “shokut” të vet për sinuset e kosinuset. Raqin e thirri detyra e PKS-së të dilte shpejt në mal si komisar i çetës së komanduar nga patrioti Riza Kodheli dhe pastaj si intendent i Shtabit të Qarkut të Korçës. Të ishte intendent i një ushtrie popullore, të cilën ku e zinte mbrëmja, s’e zinte mëngjesi, i një ushtrie pa kazerma, pa industri, pa armatim e pajisje, pa depo, pa mjete ndërlidhjeje, por vetëm me “koeficientin” më të lartë, siç thoshte Raqi, i besimit të patundur në drejtësinë e çështjes dhe në fitoren e popullit, nuk ishte as punë e thjeshtë dhe as e lehtë. Raqit i duhej të siguronte veshmbathjen, ushqimet, armët, municionet etj. dhe të lejonte harxhimin e çdo gjëje me kursimin më të madh. Sado i vështirë të ishte “polinomi” në algjebërën gjithmonë të ngatërruar të intendentit, Raqi dinte të zgjidhte çdo problem të matematikës. Atij i vinte keq për humbjen kot të gjësë më të vogël që mund t’i shërbente luftës. Njerëzit që kishin fjalë shumë e punë pak, ai i quante “qymyr i lagur” që kërcet, s’të ngroh dhe njerëzit që s’mendonin thellë për ruajtjen e mjeteve luftarake, i quante “dorë e mendje shpuar”. Sa i rreptë ishte me të tjerët, aq i rreptë ishte Raqi dhe me veten e tij. Nuk diti sa ishte gjallë se ç’ ishte gjumi i plotë, se ç’ ishte dreka e darka dhe se ç’ ishte pushimi. Tani ndodhej këtu pastaj atje, sot në mal, nesër pa gdhirë në fushë. Brenda një kohe të shkurtër përshkonte, kaluar apo në këmbë, ditën apo natën, në zheg apo në tufan, të gjithë rrjetin e gjerë të bazave të vendit. Gjithë kjo punë e vështirë, në kushte të vështira s’ia hoqi kurrë buzagazin Raqit. Ai sa herë që e takoje ishte shend e verë me të gjithë, i dashur me secilin, por i rreptë e parimor, kur e donte puna.

Ishte maji i vitit 1943. Voskopoja, kjo qendër partizane e krahinës së Korçës, gumëzhinte nga këngët partizane. Njësitë luftuese po bëheshin gati për udhë për të goditur armikun në qytetin e Leskovikut. Bashkë me partizanët atë ditë ishin dhe një numër i madh nxënësish të shkollave të mesme të Korçës. Ata kishin lënë librat për të kapur pushkën e lirisë. Tani nxënësit e Raqit ishin bërë shokët e tij. Asnjëri prej tyre nuk pranoi të mos merrte pjesë në aksionin kundër garnizonit armik të Leskovikut. Kjo e gëzoi Raqin, sepse këta nxënës ishin nga ata që në shumë raste i kishte edukuar vetë. Ai i mbloodhi të gjithë ata djem të rinj për t’u folur dhe nuk i lëshonte kot fjalët Raqi. Kur ishte puna për fjalë e thjeshtonte tek s’mbante më shprehjen algjebrike dhe priste shkurt. Prandaj, duke buzëqeshur e nisi dhe e mbaroi kështu fjalën e tij atë ditë: “Dëgjoni këtu! Në shkollë disa prej jush kanë marrë pesa në provimet e matematikës. Në notat unë kam qenë i rreptë, ju e dini mirë. I rreptë jam dhe tani, por ju e dhatë provimin shkëlqyeshëm këtu në mal!”

Raqi Qirinxhinë e donin dhe e nderonin jo vetëm nxënësit dhe shokët e tij, por të gjithë ata që kishin rastin ta njihnin, qoftë dhe pak. Atë e urrenin shumë armiqtë e popullit dhe ky ishte një plus tjetër për këtë nxënës, mësues dhe luftëtar të shquar.



Lejla Malo

E plagosur e masakruar, e torturuar fizikisht, por Lejla Malo qëndronte kryelartë dhe e qetë përpara xhelatëve.

Ajo që ndodhi me partizanen Lejla Malo në Delvinë, mund të jetë një nga rastet më të rralla të egërsisë njerëzore që ka ndodhur ndonjëherë ndaj një vajze të re 15 vjeçare, e cila sakrifikohej për lirinë e Atdheut, duke u masakruar dhe shpërfytyruar fizikisht. Le të kujtojmë një shembull nga tragjedia “Iliada” e Homerit. Gjatë dyluftimit midis Akilit dhe Hektorit, babai i Hektorit, duke parë se përbindëshi Akili po e fitonte dyluftimin, iu lut kundërshtarit që të mos e shpërfytyronte Hektorin. Mbi egërsinë shtazarake fitoi arsyeja njerëzore. Akili e mundi kundërshtarin e tij, por nuk e dëmtoi fizikisht në fytyrë. Ndërsa nazistët dhe ballistët egërsira Lejla Malos i bënë çdo lloj torture dhe kur ajo kishte vdekur, e tërhoqën zvarrë nëpër rrugët e qytetit të Delvinës për të trembur njerëzit që të mos i bashkoheshin LANÇ-it.

Lejla Malo lindi në dhjetor të vitit 1929. Në moshën 15 vjeçare ajo doli partizane dhe u inkadrua në batalionin “Thoma Lula”. Partizania më e re dhe më e vogël e batalionit, u bë shpejt e njohur, e dashur me të gjithë, megjithëse jeta e saj si partizane zgjati vetëm 10 ditë!



● Raqi Qirinxhinë e donin dhe e nderonin jo vetëm nxënësit dhe shokët e tij, por të gjithë ata që kishin rastin ta njihnin, qoftë dhe pak. Atë e urrenin shumë armiqtë e popullit dhe ky ishte një plus tjetër për këtë nxënës, mësues dhe luftëtar të shquar.

Me urdhër të shtabit të Zonës së Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë, më 18 korrik 1944, grupit të katërt iu ngarkua detyra të sulmonte forcat gjermano-balliste që ishin dislokuar në Delvinë. Lufta ishte e ashpër. Lejla me skuadrën e saj luftonte në kalanë e qytetit. E rrethuan nga të gjitha anët. Ajo nuk e humbi kurajën, por vazhdoi të qëllonte si një luftëtare e regjur e u përgjigjej me zjarr thirrjeve të ballistëve për t’u dorëzuar. Por armiqtë e kapën Lejlan të gjallë. E plagosur rëndë në një këmbë, ajo nuk arriti të tërhiqej.

Kriminalët ballistë u vërsulën kundër saj si ujqër të tërbuar dhe e masakruan barbarisht partizanen 15 vjeçare. Në vend të ujit që kërkonte ajo për të njomur buzët e thara, ata i jepnin goditje me kondakët e pushkëve.

E plagosur, e masakruar, e torturuar fizikisht, Lejla Malo qëndronte kryelartë dhe e qetë përpara xhelatëve. Atë mëngjes korriku, populli i Delvinës pa një skenë të llahtarshme. Ballistët si bisha të etur për gjak, pasi nuk mundën ta thyenin vullnetin e saj të hekurt, u munduan ta shfrytëzonin këtë rast për t’i futur tmerrin dhe për ta larguar nga lufta për liri popullin patriot të Delvinës. Pas torturave çnjerëzore që i bënë, ata e zvarritën në rrugët e qytetit, ndërsa në sytë e saj shkëlqente drita e pashuar e idealit dhe e besimit në fitoren e LANÇ-it.



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ:
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-n

Ndër shekuj, por veçanërisht gjatë 10-vjeçarit të fundit (mbas pushtimit “de fakto” të Krimesë nga Rusia), pesha e “Armës së Dezinformimit” si pjesë e paketës së kërcënimeve hibride, mbetet në fokusin e Institucioneve, Kolegjeve, Instituteve, Medias, NGO-ve, që merren me çështjet strategjike të sigurisë.

Duke konsideruar rrezikun që vjen nga dezinformimi Rus në luftën “jo vetëm për Ukrainën”, më posaçërisht në Ballkanin Perëndimor, Uashingtoni dhe Brukseli, kanë konfirmuar ngritjen e Komisionit të Dezinformimit në rajon, si një mekanizëm për mbrojtjen nga dezinformimi Rus, Kinez si dhe vegla/shtete të tjera jo-miqësore me interesat kombëtare dhe Aleancën euroatlantike (USA/NATO/UK/BE).

E parë nga këndvështrimi euroatlantik (në 360°), ndër kërcënimet dhe oportunitetet hibride, dezinformimin e gjej si tortë të helmatisur ose thikë që rrotullohet në shpinën e interesave gjeopolitike të RSH-së.

Në “kapacitetin e Ekspertit të Sigurisë Kombëtare, Rajonit dhe NATO”, çmoj që përtej oscilacioneve bolshevike jo vetëm në Moskë dhe Beograd, të sjellë në vëmendjen kombëtare një përmbledhje me definicione, historikun, aktorët, me konkluzione si dhe rekomandime Euroatlantike:

Paketa e kërcënimeve hibride, ndërthur luftën politike, ekonomike, ushtarake, kibernetike, ndërsa definicioni akademik i posaçëm për dezinformimin si: informacion i rremë i përhapur jo thjesht dhe vetëm për të mashtruar njerëzit e zakonshëm, por si aktivitet i mirë-orkestruar me mashtrime dhe taktika të manipulimit të medias, influencuar në zgjedhje si dhe depërtuar te vendimmarrësit me qëllim për të dominuar mbi kundërshtarët si dhe për të përmbushur objektivat strategjike, ushtarake, ekonomike, etnike, dhe gjeopolitike.

Rreth 2000 vjet më parë, Republika Romake po përballej me luftë civile midis Oktavianit, djalit të birësuar të gjeneralit Julius Caesar dhe Mark Anthony, komandantit më të besuar të Tij. Për të marrë mbështetjen publike, Oktaviani nisi një luftë dezinformuese (sot fake news), duke mashtuar se Mark Anthony, kishte një lidhje me Kleopatërën, mbretëreshën egjiptiane, pra e preku shoqërinë në thelbin e vlerave romake. Po për shkak të kësaj, fitoi luftën dhe u bë perandori i parë i Romës, duke sunduar për 40 vjet.

Lufta e Parë Botërore (1914-1918), dezinformimi luajti rol vendimtar, duke i bërë thirrje shpirtit patriotik: “Vendi juaj ka nevojë për Ju” ose “Baba, çfarë jeni duke bërë për Luftën e Madhe”? Kështu Britanikët u përgjenduan në diskretitimin e armikut në front, si p.sh “forcat gjermane përdornin kufomat e ushtarëve të tyre për të zier për yndyrë, miell kockash si ushqim për derrat”. Zyrtarët e dinin se kjo nuk ishte e vërtetë, por ajo ndihmoi që gjermanët të urrëshin dhe luftoheshin si armiqtë më barbar të historisë së njerëzimit.

Lufta e Dytë Botërore (1939-1945): Nazizmi u ngrit por (po edhe u rrëzua) nga “fushata dezinformuese më famëkeqe në histori”. Goebbels themeloi Ministrinë e Publikut për Propagandën për të përhapur urrejtjen kundër hebrenjve, duke keq-përdorur fuqinë e medias, televizionin, teatrin, shtypin. Ndërsa koalicioni i fitimtareve (USA/Rusi/Angli, etj.), e ndërtoi mbështetjen e gjerë popullore në strategjinë e kundër-propagandës mbi krimet çnjerëzore të nazi-fashizmit, p.sh. në krimet dhe mizoritë e Holokaustit.

Lufta e Ftohtë (1945-1991): Krahës garës së armatimit dhe strategjisë së shkurajimit (të armiqve, duke e dominuar me forcën e armëve, përfshi të shkatërrimit në masë/atomike) gjatë 45 viteve perëndimi, i udhëhequr nga SHBA-të e gjunjëzoi Rusinë edhe në fushatën e dezinformimit, duke marrë mbështetje botërore për luftën me “djajt e kuq, që ishin edhe më çnjerëzorë se nazi-fashistët!

Gjithsesi pranohet se kampi lindor/BRSS, ishte më i strukturuar në përhapjen e dezinformatave, ndërsa perëndimi/SHBA-të, krijuan një strukturë ndër-institucionale (Grupi i Punës për Masat Aktive), i sfidoi me sukses masat aktive sovjetike deri në vitet 1990. Përveç eksperiencës me BRSS, përmendet edhe lufta në Vietnam, kur USA përdori sloganin: “Nëse Vietnam bie nën kontrollin komunist, fqinjët e tij do të pasonin edhe shumë më keq”.

Ndërsa dezinformimi qesharak i regjimit komunist, se: “Do na sulmojë NATO, Varshava, ose të dyja së bashku”, qasje që për 45 vjet e vetë-gjunjëzoi RPSSH dhe rrrokullisi në mjerim shqiptarët.

Pas viteve 1990, lindja e internetit, decentralizimi i burimeve dhe rritja e aktorëve në shpërndarjen e informacionit ka krijuar një platformë më të favorshme për dezinformimin. Zhvillimi i teknologjisë ka ndihmuar që “lajmet/fotot-fake”, të deformohen ndërsa politikanët vendas e keq përdorin këtë si avantazh për të sulmuar mediat, duke i quajtur lajmet e vërteta “lajme të rreme”, duke ndihmuar që ato të merrnin më shumë audiencë pasi njerëzit nuk po dinin kujt t’i besonin?

Me këtë rast, sjellim në kujtesë se ndër mësimet e nxjerra nga fushata e përballjes dhe mposhtjes së Millosheviçit, ishte

Dezinformimi, tortë e helmatisur ndaj interesave Kombëtare!



strategjia e dezinformimit dhe e mashtrimit, çka bëri që NATO gabimisht të bombardonte autokolona me civilë, ura dhe infrastruktura transporti, ambasadën Kineze, makete njësisht ushtarake të Aviacionit dhe artilerisë, etj. Si shembull të peshës së “Fake News”, mundet të përmendim gjithashtu, faktin që përpara Brexit/UK, kishte vetëm 2 herë më pak mbështetës të Brexit, por ata ishin gjithashtu 5 herë më aktivë se aktivistët kundër.

Po ashtu, përmendim përdoruesit nga Rusia të mediave sociale dhe ndikimin te rezultati i zgjedhjeve në 2016 në SHBA, midis Hilary Clinton dhe Donald Trump. Për këtë, 13 shtetas rusë dhe agjenci ruse interneti u paditën nga DASH si komplot për të prishur zgjedhjet amerikane, por Putini këmbënguli se të kjo nuk ishte punë e qeverisë ruse. Edhe në zgjedhjet në Francë dhe Gjermani në 2017, u konfirmua se ¼ e historive politike të shpërndara në Twitter ishin bazuar në dezinformata, prandaj me ligj u vendosen gjoa mbi 50 milionë dollarë mediave që nuk heqin menjëherë ato me përmbajtjen të paligjshme.

Referencat: Maj 2024, SHBA dhe BE kanë konfirmuar ngritjen e një mekanizmi të përbashkët koordinues që fokusohet tek lufta kundër dezinformimit që prodhohet nga Rusia dhe Kina në Ballkanin Perëndimor. Ndër të tjera theksohet, se ky mekanizëm i ri do të forcojë “mbrojtjen nga dezinformimi” si dhe forcimin e qeverisjeve demokratike dhe sundimin e ligjit rajon. Më qartë se kaq nuk ka si të thuhet/bëhet.

Direktiva 483 e APN, duke marrë në konsideratë mësimet e nxjerra në Ukrainë, Ballkan, etj., Asambleja Parlamentare konkludon se dezinformimi mbetet një kërcënim serioz për paqen, sigurinë, stabilitetin afatgjatë, rendin demokratik, kohezionin dhe interesat gjeopolitike të Aleancës. Nëpërmjet kësaj rezolute, NATO rekomandon dhe nxit vendet anëtare, posaçërisht të Ballkanit perëndimor, për të ngritur mekanizma gjithëpërfshirëse të vlerësimit të riskut si dhe mbrojtjes nga dezinformimi.

Kodi i Sjelljes ndaj Dezinformimit, 2022. Në vitin 2022, Parlamenti European dhe një listë aktorësh të medias, platformat online, dhe shoqëria civile, për herë të parë nënshkruan këtë marrëveshje/kod për të mbrojtur nga dezinformimi, duke marrë përgjegjësitë reciproke.

Qendra Europiane e Ekselencës për luftën Hibrite (European Center of Excellence for Countering Hybrid Threats), e cila në 7 vite eksperiencë mbetet referencë e mirënjohur për vlerësimet dhe rekomandimet strategjike në lidhje me mbrojtjen nga rreziqet hibride përfshi dezinformimin.

Pse mekanizmat e mbrojtjes nga dezinformimi Ruso-Kinez dhe Serb, mbeten domosdoshmëri për Ballkanin? Pse kjo mbart vëmendje strategjike për Aleancën Euroatlantike?!

Duhet ta pranojmë se propaganda bolshevike mbetet një histori suksesi jo vetëm në Ballkan. Por, mbas 2014 (Krimesë), Rusia e ka modernizuar industrinë e dezinformimit që përfshin Institucionet, Patrikanën, grupe dhe kompani private, si: Akademia e Shkencave, Byroja Federale Kundër Inteligjencës, televizioni shtetëror (Kanali 1, Rusia 2, Rusia 24, Rusia Sot, etj.), që militojnë vlerat ruse dhe Putinin; që manipulojë opinionin brenda dhe jashtë Rusisë, duke punuar me diasporat rusisht folëse, përfshirë jo - rusë të komuniteteve në mbështetje të urrejtjes ndaj Ukrainës, Perëndimit, SHBA-së, NATO-s, BE-së, Shqiptarëve, etj.

Përqasja e Rusisë - Putiniste në rajon paraqet një zgjatim të fushatës së dezinformatave në Ukrainë ndërmjet 2014 - 2024, duke u bërë shembull i prodhimit të informacionit të rremë, krijimit të miteve politike dhe falsifikimit të historisë për të justifikuar vendimet politike të marra si brenda Rusisë ashtu edhe në rrafshin gjeopolitik. Për ta konfirmuar këtë, përmendim një studim të porositur nga PE, i cili ngrinte alarmin se: “dezinformimi Rus është pjesë endemike dhe e kudondodhur e politikës në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor”, ndërsa shton se: “ka prova se shumica e mediave në Ballkanin Perëndimor janë të paktën bashkëpunëtorë në një formë të dezinformimit ose në një tjetër”.

Sigurisht, qendra e gravitetit mes aktorëve të jashtëm në rajon, mbetet Rusia, që nëpërmjet dezinformimit, përpiqet të përforcojë çdo ndarje sociale, politike, ekonomike, historike,

fetare dhe ideologjike, që do të minonte kohezionin politik, ekonomik, fuqinë ushtarake dhe orientimin euroatlantik. Ndërsa Kina, me investime pragmatike, kërkon të vendosë hegjemoninë në tregjet ekonomike në rajon dhe Mesdhe.

Por, pavarësisht diskutimeve rreth dezinformimit, aktorët e huaj nuk janë fajtorët e vetëm, pasi shumica e njerëzve dhe organizatave që prodhojnë dhe shpërndajnë dezinformim janë aktorë të brendshëm. Ndër aktorët, e brendshëm qëndron presidenti serb Vuçiç, i cili pasi ka dështuar për të bërë viktimmë apo për të pirë nga 4 nëna (Moskë, Uashington, Bruksel, Pekin), së fundmi dalldisi se: “solidariteti i BE-së është një përrallë”, presidentin Xi Jinping e quajti “vëllain e tij” si dhe bëri thirrje për “miqësi prej çeliku” me Kinën.

Me gjithë përpjekjet dhe përparimin për t’u larguar nga urrejtja dhe gjakderdhja shekullore, politika e jashtme në Ballkanin Perëndimor mbetet ende konfuze. Por nuk ka askush mëdyshje se masha e burimeve të dezinformimit Rus dhe Kinez në Ballkan mbetet Serbia dhe fundamentalistët e tipit Dodik. Sondazhet në Serbi dhe republikën Srpska tregojnë se mbi 57% mbështesin politikën e jashtme me Rusinë dhe Kinën, ndërsa vetëm 13% besojnë BE-në. Ndërkohë, për RSH, Kosovë, MV, Mal i Zi, mbi 75% besojnë në BE/NATO.

Ndërsa në raport me Kosovën, përsërisim se, përveç kërcënimeve donkishoteske me fuqinë ushtarake (70% e ekspozuar në kufi me Kosovën/KFOR), Beogradi ka ri-nënshkruar (si karshillëk ndaj USA) marrëveshje strategjike bashkëpunimi me Rusinë, duke e mitizuar Putinizmin si një mbrojtëse të interesave kombëtare serbe, ndërsa cinikët mendojnë që: “orientimi pro-rus mbetet edhe nëse vetë Rusia nuk do të ekzistonte”.

Konkluzione dhe 5 rekomandime strategjike:

Dezinformimi mbetet një kërcënim serioz për bashkëjetesën paqësore, demokracinë funksionale, axhendën e integritetit euroatlantik, në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni, Serbi, Bosnje-Hercegovinë), si dhe interesat kombëtare në rajon dhe në Mesdhe.

Aktorët e jashtëm, mbeten Rusia në rrafshin gjeopolitik, Kina në rrafshin ekonomik, si dhe masha e tyre, Serbia e oscilacioneve të Millosheviçit. Veçmas, apo së bashku manipulojnë informacionin si dhe konfuzionin demokratik, gjeopolitik për të çuar përpara interesat e tyre në rajon.

Aktorët brenda vendit, që ushqejnë dezinformimin janë politikanë mendjendryshkur, shtetarë të korruptuar, sekserë të pushteteve, interesat e krimit të organizuar dhe mediat e paguara jo vetëm në Beograd dhe Banja Luka, që kanë të vetmin qëllim për të helmuar dhe devijuar orientimin e vendeve si dhe pikëpamjet e njerëzve, duke na bërë të pyesim për kë do të votojmë dhe kujt duhet t’ia besojmë ardhmërinë euroatlantike?

Konfuzioni gjeopolitik për shkak të Luftës në Ukrainë dhe zgjedhjeve në USA (Kush do ta fitojë luftën? Po zgjedhjet në SHBA?); ndërsa BE-ja ende ngurron për integrimin e 6 vendeve të rajonit me qasjen ndaj zgjerimit në lindjen komuniste: “better in than out”, e aplikuar me sukses nga NATO.

Mbështetur në këtë rezime, në vijim gjeni 5 (pesë) rekomandime strategjike:

(1). Ngritja (jo vetëm për të qenë OK me Uashingtonin dhe Brukselin) e Komisionit gjithëpërfshirës Parlamentar të Dezinformimit.

(2). Ngritja e Bordit të Dezinformimit (BD) si një bord këshillues, monitorues dhe kontrolli i Kuvendit për mbrojtjen e interesave kombëtare nga rreziqet hibride, me fokus dezinformimin.

(3). Zhvillimi i një koncepti “on paper” (strategji) dhe procedurave standarde për të përcaktuar aktorët dhe përgjegjësit/ë e mbrojtjes nga dezinformimi Ruso - Serbo - Kinez, por jo vetëm.

(4). Sipas eksperiencës së vendeve të BE/NATO, Hartimi dhe miratimi i marrëveshjes/Kod Sjelljes ndaj rreziqeve të Dezinformimit, i cili do të duhet nënshkruar nga një listë aktorësh shtetërorë (kuvendi), me strukturat relevante të Inteligjencës, mediat, shtypi, platformat online, shoqëria civile, qendra studimi, NGO, etj., që bashkohen për të luftuar dezinformimin dhe angazhohen për përmbushjen e detyrimeve të tyre.

(5). Anëtarësimi i RSH (nënshkrimi MoU) në Qendrën Europiane të Ekselencës për mbrojtjen nga Kërcënimet Hibride (përfshi dezinformimin), e cila në vetëm 7 vite eksperiencë shërben si një referencë e mirënjohur për vlerësimet dhe rekomandimet strategjike në përballjen me rreziqet hibride, përfshi këtu dhe dezinformimin. HCoE është themeluar në Helsinki në 2017 me 9 anëtar; zgjeruar me 35 Shtete të BE/NATO-s, përfshi vendet e rajonit (jo RSH dhe Kosova) si Mal i Zi, Kroaci, Maqedoni, Slloveni, etj.

Në përmbyllje “torta e helmatisur nga dezinformimet e Rusisë - Putiniste”; ambiciet gjeo-ekonomike të Kinës, ushtarët e oscilacioneve të Millosheviçit në Beograd apo Dodikët e drogim nga Moska, jo vetëm kërcënojnë sovranitetin territorial të Kosovës, por edhe stabilitetin dhe axhendën e integritetit të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (përfshi Serbinë), si dhe sfidojnë seriozisht vlerat demokratike, fuqinë ushtarake, kohezionin dhe interesat e Aleancës Euroatlantike në rajon (USA/NATO/UK/BE)”.

Shqipëria në rrugëtimin e saj historik

5 qershor 1478, Kruja ra në duart e turqve

Luftimet e vitit 1474 treguan se luftëtarët shqiptarë ishin ata që mbrojtën me gjakun dhe jetën e tyre qytetin e Shkodrës, duke përballuar me heroizëm sulmin e forcave osmane. Shqiptarët luftonin me vetëmohim kudo që ndodheshin, si mbrojtës të kështjellës, si sulmues në rrethinat e Shkodrës etj. Prandaj Republika e Venedikut u kujdes të forconte lidhjet me ta, duke u kushtuar vëmendje sidomos marrëdhënieve me fisnikët shqiptarë, si me Dukagjinët, Gjurashët, Stres Balshajt, Arianitët etj.

Pas rrethimit të parë të Shkodrës, sulltan Mehmeti II i angazhoi ushtritë osmane kryesisht me pushtimin e brigjeve të Detit të Zi dhe pas dy vjetësh i drejtoi ato kundër Shqipërisë Qendrore e të Epërme.

Dështimi i fushatës ushtarake të vitit 1474 e bindi sulltan Mehmetin II se për pushtimin e kështjellave shqiptare duhej përdorur i gjithë potenciali ushtarak i Perandorisë Osmane dhe se ato duhej të sulmoheshin radhazi.

Për zbatimin e këtij plani trupat osmane erdhën përsëri në Shqipëri në vitin 1476, rrethuan Krujën, që ishte për ta pengesa më e rëndësishme në drejtim të Shkodrës.

Republika e Venedikut, duke vlerësuar rëndësinë strategjike të Krujës për mbrojtjen e zotërimeve të saj në Shqipëri, u përpoq të lidhej sa më shumë me shqiptarët dhe kërkoi që të kthehej në Shqipëri djali i Skënderbeut, Gjon Kastrioti, i cili jetonte në pronat që kishte trashëguar në Mbretërinë e Napolit. Për mbrojtjen e Krujës Venediku vendosi këtu 300 stratiotë shqiptarë të sjellë nga Moreja.

Për të liruar Krujën nga rrethimi u formua një ushtri e përbashkët shqiptaro-veneciane, e cila në vitin 1477 sulmoi trupat osmane, që mbanin të rrethuar Krujën, dhe u shkaktoi atyre humbje të rënda. Në vend që fitorja të çohej në fund, ushtria shqiptaro-veneciane ra pas plaçkës së madhe të kampit armik, veprim ky që u dha mundësi forcave kundërshtarë të riorganizoheshin menjëherë dhe të ndërmerrnin një sulm të befasishtëm. Trupat osmane siguruan një fitore të plotë mbi ushtrinë shqiptaro-veneciane dhe vazhduan kështu rrethimin e Krujës.

Në pranverë të vitit 1478 trupa të freskëta osmane filluan të marshonin mbi tokat shqiptare dhe më 14 maj kontingjentet e para të tyre rrethuan Shkodrën. Brenda një kohe të shkurtër, deri më 15 qershor, ato u përforcuan me ardhjen e ushtrive të tjera të drejtuara nga bejlerbeu i Rumelisë, nga bejlerbeu i Anadollit, si dhe nga vetë sulltan Mehmeti II.

Pas një rrethimi dyvjeçar mbrojtësit heroikë të Krujës dhe banorët e strehuan në kështjellë, të mbetur pa asnjë lloj ushqimi, u detyruan të pranonin kërkesën e sulltanit për dorëzimin e kështjellës me kusht që të largoheshin të lirë nga qyteti. Më 16 qershor të vitit 1478, trupat osmane hynë në kështjellën e Krujës, por sulltani nuk e mbajti premtimin dhe ata, me përjashtim të qeveritarit venecian, vranë të gjithë meshkujt e rritur që gjendeshin në Krujë, ndërsa gratë e fëmijët i kthyen në skllavër.

Pasi mori Krujën, sulltani kërkoi pushtimin e menjëhershëm të Shkodrës. Prandaj të gjitha forcat ushtarake osmane u përqendruan në luftë për pushtimin e saj.

Ashtu si gjatë rrethimit të vitit 1474, krahas qytetarëve shkodranë, në luftën për mbrojtjen e Shkodrës, në 1478, morën pjesë edhe banorë të rrethinave e të viseve të tjera shqiptare, duke përfshirë edhe bashkëluftëtarë të Skënderbeut. Në radhët e tyre ishin edhe anëtarë të familjes së njohur shkodrane Dukagjini, nga të cilat ranë në fushën e nderit Teodori dhe Budomiri.

Për të mposhtur mbrojtësit e Shkodrës, si asnjëherë më parë, osmanët përdorën gjerësisht artilerinë, të cilën e vendosën rreth kështjellës. Vetëm topa të rëndë ishin mbi 10. Prej më se një muaji mijëra predha goditën vazhdimisht muret e Rozafës, të cilat i dëmtuan rëndë. Edhe pse në shumë vende muret u rrafshuan, mbrojtësit e kështjellës u përleshën trup me trup me forcat osmane dhe i zmrapsën e i thyen sulmet e vazhdueshme të tyre. Në këto luftime të rrepta krahas burrave morën pjesë edhe gratë e strehuara në kështjellë.

Humbje të rënda trupave osmane u shkaktuan edhe luftëtarët që vepronin në rrethinat e Shkodrës. Këta sulmonin vazhdimisht nga drejtime të ndryshme, sidomos duke ardhur me varka nga liqeni i Shkodrës dhe nga bregu i përtejme i Bunës.

Deri në fillim të muajit gusht të vitit 1478, trupat osmane e sulmuan vazhdimisht kështjellën e Rozafës, por pa ndonjë përfundim dhe me humbje të rënda për ta. Prandaj sulltan Mehmeti II vendosi t'i mposhte mbrojtësit e saj nëpërmjet urisë, duke forcuar rrethimin e tyre. Për këtë ai ndërmori sulme mbi të gjitha kështjellat e tjera në afërsi të Shkodrës, si Zhabjaku, Drishti e Lezha, që shërbenin si baza të rëndësishme strehimi e furnizimi për luftëtarët shqiptarë që vepronin jashtë kështjellës së Rozafës.

Detyra për pushtimin e kështjellës së Zhabjakut, që ishte në brigjet e liqenit të Shkodrës, iu ngarkua ushtrisë së bejlerbeut të Rumelisë. Mbrojtësit e Zhabjakut, ku e kishte selinë Gjon Gjurashi (Cërnojevci), djali i Stefanit që kishte vdekur rreth vitit 1465, nuk bënë asnjë qëndresë dhe ua dorëzuan kështjellën trupave osmane.

5 qershor 1902, Filip Ashiku shkruan për thesarin e zbuluar në fshatin Vrap

Në letrën e datuar më 5 qershor 1902, mësuesi i parë i shkollës shqipe në Tiranë, Filip Ashiku, shkruan për thesarin e zbuluar në fshatin Vrap, një fshat në ish-bashkinë e Baldushkut në Qarkun e Tiranës, shumë objekte antike në ar, në mesin e tyre një kupë ari 300 gram me



katër figura, secila prej tyre në mbishkrim grek, përveç saj edhe dy monedha ari, një shpatë dhe artikuj të tjerë. Ky zbulim i rrallë i quajtur “Thesari Shqiptar” tani ndodhet në Muzeun Metropolitan të Nju Jorkut. Disa nga këto artikuj në foto.

5 qershor 1992, Shqipëria u pranua në Këshillin e Bashkimit të Atlantikut Verior

Gjysma e dytë e viteve 80-të të shek. XX, shënoi një zbutje të tensionit Lindje-Perëndim dhe fillimin e bisedimeve midis presidentëve amerikanë, Regan dhe Bush, me Mihail Gorbacov, kreu i BRSS, mbi mundësitë e frenimit të garës së armatimeve, konkretisht shkurtimin e armëve konvencionale dhe raketave me rreze të mesme veprimi. Shkrija e akujve të Luftës së Ftohtë dhe kriza e thelle ekonomike dhe politike në BRSS, u shoqërua me fillimin e tronditjes së regjimeve komuniste në Evropën Lindore e Ballkan dhe transformimet politike në këto shtete, duke u orientuar drejt demokracive liberale. Në këtë kuadër të ri zhvillimesh edhe organizatat ndërkombëtare që kishin funksionuar në kuadër të Bllokut Perëndimor si KSBE, TPE apo NATO, rishikuan misionet e tyre dhe mbështetën përpjekjet e vendeve të Evropës Lindore e Qendrore drejt rrugës së tyre evropianizuese.

Pas daljes nga Traktati i Varshavës, 1968, një aleancë ushtarake e Bllokut të Lindjes, Shqipëria nuk bëri pjesë në asnjë aleancë ushtarake gjatë Luftës së ftohtë, pjesë e vetëizolimit të saj. Ajo e shikonte me frikë dhe me frymë armiqësore NATO-n, si aleancë ushtarake e Bllokut Perëndimor. Në gjysmën e dytë të viteve 80-të, në kuadër të procesit të pashmangshëm të hapjes ndaj Perëndimit, qeveria shqiptare filloi të interesohej edhe për pozicionin e NATO-s në këtë situatë të re, ndryshimet në strategjinë e saj të sigurisë dhe vendin e Shqipërisë në këtë strategji. Shqipëria, si vend jashtë blloqeve dhe e pozicionuar në kufi të blloqeve, përbënte një pikë shumë të rëndësishme për NATO-n në strategjinë e saj të sigurisë. Gjatë një turneu në Evropë, dhjetor 1989, Sekretari i Shtetit Bejker, deklaroi se: “..Perëndimi duhej të krijonte një Evropë të re të mbështetur në një Atlantizëm të ri e se NATO duhej të shndërrohej në një organ politik, i aftë për të ndërtuar një strukturë të re sigurimi për Evropën..”. Ambasadat shqiptare në vendet perëndimore udhëzoheshin të merrnin informacion nëse këto deklarata ishin rezultat i bisedimeve Bush-Gorbaçov, dhe a flitej për Shqipërinë në takimet e NATO-s.

Pas pranimit të Shqipërisë në KSBE, qershor 1991, për Shqipërinë u krijuan mundësi të reja për të rritur interesin ekonomik ndaj saj dhe për të qenë pjesë e sigurisë evropiane në një botë të ekspozuar ndaj rreziqeve të reja pas shkrirjes së akujve të Luftës së Ftohtë mes dy blloqeve.

Në gusht 1991 nga NATO mbërrin ftesa e parë për Shqipërinë, nëpërmjet ambasadës shqiptare në Romë, për të marrë pjesë në kurse

të shkurtra të specializuara pranë strukturave trajnuese të NATO-s në Itali e Gjermani për të gjitha vendet anëtare të KSBE-së, duke e konsideruar këtë “ ..një hap të mëtejshëm pozitiv në rrugën për një hapje më të madhe, besim dhe mirëkuptim reciprok..”. Duke e konsideruar këtë moment “ ..si një ndryshim të politikës së NATO-s ndaj Shqipërisë”, në kushtet e ndryshimit të klimës politike në Evropë qeveria shqiptare miratoi pjesëmarrjen e ambasadorit të RSH në Romë në këtë aktivitet. Si vend anëtar i KSBE-së Shqipëria mori pjesë në tetor 1991 edhe në seminarin ndërkombëtar “NATO në udhëkryq” me fokus në ristrukturimin e sigurisë evropiane, të organizuar nga Aleanca.

Në nëntor 1991, në një takim të nivelit të lartë të NATO-s të mbajtur në Romë, u vendos krijimi i “Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut”, ku do të merrnin pjesë 16 anëtare të NATO-s, 6 anëtarë të ish-Traktatit të Varshavës dhe tre shtetet baltike që sapo ishin shpallur të pavarura. NACC ishte organizmi i parë që krijoi Aleanca për të vendosur marrëdhëniet me vendet që dolën nga regjimet komuniste në Evropën Lindore e Qendrore. Mbledhja themeluese e tij do të mbahej, më 20 dhjetor 1991, në Bruksel, ku pritej të miratohej një deklaratë politike e përbashkët për të shënuar fillimin e një epoke të re partneriteti e të institucionalizohet



marrëdhënia e këtyre vendeve me NATO-n. Jashtë këtij Këshilli kishin mbetur Shqipëria dhe vendet neutrale apo të paangazhuara. Në kuadër të synimit për vendosjen e marrëdhënieve me NATO-n, qeveria shqiptare filloi përpjekjet në skenën diplomatike ndërkombëtare, aq sa ajo e kishte të mundur për kohën, që të përfshihej në këtë Këshill e të merrte pjesë në mbledhjen e 20 dhjetorit për të njohur klimën e re brenda organizatës.

Përgjigjja ishte negative. Në këtë takim vendet anëtare të NATO-s u shprehën se: “...kemi ndjekur nga afër zhvillimet në vendet e tjera të Evropës Qendrore e Lindore. Përshtendësim progresin e vazhdueshëm në drejtim të pluralizmit politik, respektimin e të drejtave të njeriut dhe ekonominë e tregut. Inkurajojmë këto vende të vazhdojnë reformat dhe të kontribuojnë në zbatimin e mëtejshëm të angazhimeve të KSBE-së dhe marrëveshjeve për kontrollin e armëve”.

Në shkurt 1992 një grup ushtarakësh të lartë nga Shqipëria morën pjesë në konferencën e organizuar nga NATO në bashkëpunim me qeverinë kanadeze “Roli i ushtarakut në shoqëritë demokratike”. Kjo pjesëmarrje u shfrytëzua për takime me përfaqësues të shteteve anëtare të NATO-s dhe me drejtues të Aleancës për të lobuar rreth pranimin të Shqipërisë në NACC në përputhje me ndryshimet pozitivi politike e ekonomike që po ndodhnin në Shqipëri. U premtua se një delegacion shqiptar do të ftohej të merrte pjesë në mbledhjen tjetër të NACC, më 1 prill 1992. Më 24 prill 1992, qeveria shqiptare iu drejtua me një letër NATO-s për pranimin e Shqipërisë në NATO-s në takimin e Oslos qershor 1992. Për takime e lobing me eksponentë të vendeve anëtare të Aleancës shfrytëzoheshin edhe mbledhje të KSBE-së, apo vizita në Shqipëri të autoriteteve të larta të vendeve anëtare.

Përpjekjet u intensifikuan pas zgjedhjeve të marsit 1992. Qeveria e re demokratike hyri në kontakte me zyrtarë të lartë të NATO-s, duke lobuar për situatën e re politike në Shqipëri dhe nevojën e Shqipërisë për të qenë pjesë e NACC.

Në takimin e 5 qershorit 1992, të NACC në Oslo, Shqipëria dhe Gjeorgjia u pranuan si anëtare të NACC dhe po atë ditë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Manfred Woerner (1988 – 1994), njoftoi zyrtarisht qeverinë shqiptare për vendimin e MPJ të vendeve anëtare të NACC. Ai i kërkoi Shqipërisë të shprehte miratimin e saj për deklaratat e NACC në takimet e 20 dhjetorit 1991, 10 marsit 1992, dhe 5 qershorit 1992. Qeveria shqiptare u shpreh pozitivisht për sa kërkohet në letrën e 30 qershorit 1992, të kryeministrit shqiptar për Sekretarin e Përgjithshëm Woerner. Që nga ky moment filluan përpjekjet për hapat e radhës deri në anëtarësimin e Shqipërisë në NATO.



PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Strategjia e Bioteknologjisë dhe Teknologjive të Përmirësimit Human të NATO-s, tashmë është e miratuar zyrtarisht nga ministrat aleatë të Mbrojtjes. Bioteknologjia dhe teknologjitë e përmirësimit human (BHE) nuk janë aspak të reja, por ritmi i paprecedentë i inovacionit në zhvillim të BHE-së është shkatërrues.

“Të nxitur nga një konvergencë me inteligjencën artificiale (AI), zhvillimet e reja në BHE kanë çuar në një biorevolucion në zhvillim, një revolucion që do të transformojë shoqërinë tonë, nga kujdesi shëndetësor dhe shëndeti publik, në prodhimin e proceseve industriale, në siguri dhe mbrojtje”. Stafi aktual i NATO-s që drejton zhvillimin dhe ofrimin e kësaj Strategjie përshkruan një nga karakteristikat kryesore të saj, grupin e parë të Parimeve të Përdorimit të Përgjegjshëm për Bioteknologjinë dhe Teknologjitë e Përmirësimit Njerëzor në mbrojtje dhe siguri.

Përparimet në BHE kanë potencialin për të adresuar disa nga sfidat më të vështira mjekësore, mjedisore dhe të elasticitetit të Aleancës. Ashtu si çdo teknologji në zhvillim dhe përçarës, teknologjitë BHE paraqesin gjithashtu rreziqe të reja për Aleancën, veçanërisht kur përdoren nga aktorë keqdashës. Të njëjtat metoda të inxhinierisë gjenetike që mbështesin përparimet mjekësore mund të përdoren për të krijuar patogjenë të rinj, më vdekjeprurës ose të synuar. Përhapja e dyfishtë e sistemeve të modifikimit të gjeneve dhe metodave të kërkimit të aktivizuara nga AI-ja do të thotë se barrierat e kostos dhe aftësive për të hyrë dhe krijuar kërcënime kimike dhe biologjike janë ulur.

“Miratimi i Strategjisë BHE të NATO-s, në shkurt 2024, është marrëveshja e parë ndërkombëtare që rregullon bioteknologjinë në zhvillim në mbrojtje dhe siguri”. Strategjia udhëhiqet, para së gjithash, nga Parimet e para në botë të Përdorimit të Përgjegjshëm për teknologjitë BHE në mbrojtje dhe siguri dhe ripohon angazhimin e palëkundur të Aleancës ndaj Konventës së Armëve Biologjike. Në zbatimin e kësaj strategjie të re, Aleanca ka mundësi të avancojë zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive BHE për qëllime mbrojtëse dhe paqësore, duke mbrojtur gjithashtu nga rreziqet e përhapura që vijnë nga këto teknologji.

Rreziqet dhe mundësitë e bioteknologjisë dhe teknologjive të Përmirësimit Njerëzor

